



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

V E N D I M

Nr. 29, datë 18.10.2023

PËR

MIRATIMIN E LEJES SË NDËRTIMIT TË INFRASTRUKTURËS:
“REHABILITIMI I INFRASTRUKTURËS SË AEROPORTIT, PËRFSHIRË PISTËN DHE
TXL WHISKEY, RRUGËT LIDHËSE DHE VENDET E PARKIMIT, PËR TË
AKOMODUAR AVIONË TË KODIT E”, ME VENDNDODHJE BRENDA TERRITORIT
TË AEROPORTIT NDËRKOMBËTAR TË TIRANËS”, BASHKIA KRUIË

Në mbështetje të neneve 27 dhe 28, të Ligjit Nr. 107, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar, si dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.519, datë 20.09.2017 “Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit”, i ndryshuar, me propozim të subjektit zhvillues shoqërisë “Tirana International Aeroport” sh.p.k, Këshilli Kombëtar i Territorit,

VENDOSI:

1. Miratimin me kusht të Lejes së Ndërtimit të Infrastrukturës: “Rehabilitimi i infrastrukturës së Aeroportit, përfshirë pistën dhe TXL Whiskey, rrugët lidhëse dhe vendet e parkimit, për të akomoduar Avionë të kodit E”, me vendndodhje brenda territorit të Aeroportit Ndërkombëtar të Tiranës”, Bashkia Krujë, me subjekt zhvillues shoqërinë “Tirana International Aeroport” sh.p.k.
2. Harta e Planvendosjes së Strukturave bashkëlidhet si pjesë përbërëse e këtij vendimi.
3. Dokumenti i Lejes së Ndërtimit i jepet subjektit kërkues vetëm pas:
 - a) plotësimit të dokumentacionit tekniko-ligjor;
 - b) pagesës përkatëse të taksës së ndikimit në infrastrukurë për llogari të Bashkisë Krujë.
4. Ngarkohet Agjencia e Zhvillimit të Territorit në bashkëpunim me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, për zbatimin e këtij vendimi.
5. Ky vendim hyn në fuqi pas nënshkrimit nga Kryetari i Këshillit Kombëtar të Territorit, Ministri i Linjës dhe Sekretari i Këshillit Kombëtar të Territorit.

KRYETARI

ED. PRAMA



MINISTËR I LINJËS
MINISTËR I INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË
BELINDA BALLUKU



SEKRETAR I KKT
DREJTOR I AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT
ADELAJDA ROKA



Nënshkruar më datë 28 / 12 / 2023